



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr.452 Prot

Përmet, më 19.02.2020

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Për: Operatorin ekonomik “NIKA” shpk

Procedura e prokurimit: *Kërkesë për propozim*

Numri i referencës së procedurës: *REF- 84590-01-22-2021*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *“Loti i I Blerje ushqime me origjinë jo shtazore dhe fruta perime”*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): s’ka

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: *çmimi më i ulët X* oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori Ekonomik “NELSA” sh.p.k me NIPT J71601012S me vlerë të ofertës 1 017 845 (një milion e shtatëmbëdhjetë mijë e tetëqind e dyzet e pesë) lekë pa TVSH.
2. Operatori Ekonomik “NIKA” sh.p.k me NIPT J76705047U me vlerë të ofertës 995 148 (nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e njëqind e dyzet e tetë) lekë pa TVSH.
3. Operatori Ekonomik “SILVER” sh.p.k me NIPT K88010301S me vlerë të ofertës 1 032 656 (një milion e tridhjetë e dy mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH

Nga verifikimi i dokumentacionit përkatës informojmë **operatorët ekonomik të skualifikuar:**

- **Operatori “NELSA” shpk**

Në kriteret e veçanta të kualifikimit pika dh) Vërtetimi që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. Ky OE ka paraqitur vërtetim të datës 29.12.2020 i cili përfshin

faturën koherente të muajit Nëntor 2020 me vlerë të llogaritur deri në 28.12.2020. Tenderi hapej në 04.02.2021 dhe duhej përfshirë fatura e muajit janar 2021.

Në pikën 2.3.6 të këtij Loti ky OE nuk ka paraqitur çertifikatat e kërkuara si më poshtë: ISO 22000:2018 (Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë Ushqimore) ose ekuivalente me të. ISO 9001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë) ose ekuivalente

Oferta te kualifikuara:

- **Operatori ekonomik “NIKA” shpk**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur për ofertën e tij në sistem (SEP) për këtë procedurë prokurimi, rezulton se *operatori ekonomik “NIKA” shpk*, plotëson kriteret e kushteve të përgjithshme, kushteve të veçanta, kërkesat e dokumentacionit të përgjithshëm administrativ, ligjor, teknik dhe ekonomik, sipas kërkesave të AK në njoftimin e kontratës dhe DT të kësaj procedurë prokurimi.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë *operatorin ekonomik “NIKA” shpk me adresë Lagjja Vasil Shanto, Bulevardi Skenderbeu, godinë 8-katëshe, kati i I-rë, Zona kadastrale 8593, nr.pasurie 5/587 SHKODËR* se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 995 148 (nëntëqind e nëntëdhjetë e pesë mijë e njëqind e dyzet e tetë) lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë *Bashkisë Përmet me adresë Sheshi “Abdyl Frashëri” kati i katërt Zyra Juridike*, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës do te veprohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 11.02.2021

Ankesa: NUK KA

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Alma HOXHA